

MASTER I SHKENCAVE NË FINANCË - KONTABILITET

Emërtimi akademik i studimit	Diplomë “Master i Shkencave” në Financë - Kontabilitet
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	AKREDITUAR me VENDIM Nr.36, datë 28.02.2025
Cikli i studimit	Cikli i dytë i studimit
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti Ekonomik , Institucion Publik, Akredituar
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vjet
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimit	1. Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet”, individët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “Bachelor” në fushën e ekonomisë ose fusha të tjera të përafërta. 2. Kriteret e pranimit për këtë program studimi janë si më poshtë vijon: a. Kriteri i meritës Nota mesatare e ponderuar e studimeve në bachelor, 7 e lart, b. Kriteri i rëndësisë Koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të NjBKF në FE. ▪ Kandidatët e diplomuar në Kontabilitet Financë në Universitetin e Gjirokastrës, në të njëjtin profil/program studimi që është bërë aplikimi, koeficienti 1.0 ▪ Kandidatët e diplomuar në Kontabilitet Financë jashtë Universitetit të Gjirokastrës, në të njëjtin profil/program studimi që është bërë aplikimi, koeficienti 0.9.

	▪ Kandidatet e diplomuar në ekonomi në Universitetit të Gjirokastrës, jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, koeficienti 0.85. ▪ Kandidatët e diplomuar në ekonomi jashtë Universitetit të Gjirokastrës, , jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, koeficienti 0.8. ▪ Kandidatet e diplomuar jo në ekonomi , jashtë profileve të studimit që është bërë aplikimi, koeficienti 0.7. c. Kuotat e paracaktuara nga Njësia bazë e Kontabilitet Financës. 3. Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programin Master i Shkencave në “Financë Kontabilitet” do të jetë rezultat i produktit: Notë mesatare në bachelor*koeficient (sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet) duke gjeneruar kështu një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj liste brenda kuotave të paracaktuara nga NJB e KF. 4. Studentët që kanë përfunduar studimet dhe janë diplomuar jashtë vendit në të njëjtin program ose programe të përafërta studimi, në rast pranimi duhet të kryejnë njësimin e diplomës pranë QSHA. 5. Kandidati duhet të ketë të mbrojtur një prej 5 gjuhët e huaja në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 10, datë 16.06.2023 (për një ndryshim në Udhëzimin Nr.52, datë 3.12.2015) , për “Përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e Arsimit të lartë, të ndryshuar” . (Niveli B1).
--	--

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Qëllimi i programit “*Master i Shkencave në Financë – Kontabilitet*” është të aftësojë studentët me njohuri më të thelluara në fushën e financës dhe kontabilitetit. Gjithë procesi akademik udhëhiqet nga disa objektiva të përcaktuara qartë duke synuar që studentët në fund të ciklit të studimit:

1. Të thellojnë njohuritë teorike dhe praktike në fushën e financës dhe kontabilitetit.
2. Të zhvillojnë aftësitë analitike dhe kërkimore për të analizuar probleme komplekse financiare e kontabël.
3. Të përgatiten për role drejtues në sektorë të ndryshëm si institucione financiare, kompani private, administratë publike, etj.
4. Të jenë të aftë të kontribuojnë në zhvillimin shkencor dhe profesional në fushën e financës dhe kontabilitetit.
5. Të jenë të përgatitur për vazhdimin e studimeve në nivelin e tretë (doktoraturë).

Gjithashtu, do të permendim edhe disa objektiva specifike:

1. Të aplikojnë metoda të avancuara të analizës financiare, përfshirë modele vlerësimi të aktiveve, riskut dhe performancës.
2. Të interpretojnë dhe përgatisin pasqyra financiare të avancuara, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare (IFRS).
3. Të kuptojnë dhe zbatojnë politikat fiskale, monetare dhe financiare, si dhe ndikimin e tyre në mjedisin ekonomik.
4. Të menaxhojnë buxhete, investime dhe strategji financiare për biznese dhe institucione të tjera.
5. Të zhvillojnë auditime të brendshme dhe të jashtme dhe të njohin teknikat bashkëkohore të kontrollit të brendshëm.
6. Të përdorin software profesionale dhe teknologji të informacionit për analiza financiare dhe kontabilitet (p.sh. Excel, SAP, QuickBooks).
7. Të analizojnë strukturën dhe koston e kapitalit, si dhe të ndërmarrin vendime për financimin e bizneseve.

Figura profesionale bazë që formohet nëpërmjet programit të studimit “*Master i Shkencave*” në Financë – Kontabilitet është ajo e Specialistit të lartë në Financë dhe Kontabilitet.

Ky specialist është i aftë të:

- Hartojë, analizojë dhe interpretojë pasqyrat financiare, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare (IFRS);
- Zbatojë politika efektive të menaxhimit financiar në organizata të ndryshme;
- Kryejë analiza të avancuara financiare dhe të marrë vendime strategjike mbi investimet, financimin dhe menaxhimin e riskut;
- Zhvillojë dhe zbatojë procese kontabël dhe buxhetore, të përshtatura me objektivat e organizatës;
- Menaxhojë dhe realizojë auditime të brendshme dhe të jashtme, në përputhje me kuadrin ligjor dhe etik;
- Aplikojë me kompetencë në sistemin tatimor, duke ofruar këshillim të kualifikuar për çështje fiskale;

- Përdorë në mënyrë profesionale software financiarë dhe të kontabilitetit, si dhe teknologji të reja të informacionit;
- Ndjekë zhvillimet e tregjeve financiare dhe të ndërtojë strategji për menaxhimin e riskut dhe të performances financiare;
- Hartojë dhe realizojë kërkime shkencore në fushat e finances dhe kontabilitetit.

Objektivat e përmendura më lart dhe të tjera aftësi që ky program synon të arrijë me studentët që ndjekin këtë cikël studimi, do të sigurojë një performancë sa më të lartë në mjedisin në të cilin do të veprojë si i punësuar në të ardhmen.

Për realizimin e këtyre objektivave, programi parashikon thellime në fusha të tilla si ato të kontabilitetit të avancuar dhe raportimit financiar, financës korporative dhe analizës së investimeve, auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, sistemit tatimor dhe planifikimit fiskal, menaxhimit të riskut dhe tregjeve financiare, si dhe në kërkimin shkencor dhe analizën e të dhënave financiare.

VEPRIMTARITË FORMUESE

1. **Lëndë të formimit të përgjithshëm** (Tregjet dhe Institucionet Financiare, E Drejte Biznesi) **Kredite (12)**
2. **Lëndë të formimit karakterizues** (Standartet Nderkombëtare dhe SKK te Kontabilitetit, Analiza e Pasqyrave Financiare, Sistemi Tatimor Tregëtar, Menaxhim Projektesh, Auditim, Drejtimi Financiar i Avancuar, Analizë Kosto, Analiza e Investimeve, Kontabiliteti Financiar i Avancuar, Organizimi i Sistemit të Kontrollit Kontabël) **Kredite (60)**
3. **Lëndë integruese** (Metodat e Kërkimit Shkencor në Financë, Teoria Moderne e Investimeve, Lëndë me zgjedhje (Shërbimet e Sigurisë dhe Konsulencës, Vlerësim Pasurie) **Kredite (18)**
4. **Lëndë të formimit plotësues** (Praktika) **Kredite (12)**
5. **Punim diplome** (Mikroteza) **Kredite (18)**

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	1 - 44 pikë
5 (pesë)	45 - 54 pikë
6 (gjashtë)	55 - 64 pikë
7 (shtatë)	65 - 74 pikë
8 (tetë)	75 - 84 pikë
9 (nëntë)	85 - 94 pikë
10 (dhjetë)	95 - 100 pikë

MUNDËSIA PËR STUDIME TË MËTEJSHME

Diploma juaj e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në *Financë – Kontabilitet* është ura lidhëse e zhvillimit të mëtejshëm akademik dhe profesional drejt ciklit të tretë të studimit. Kurrikula jonë është e dizenuar në mënyrë të tillë që të ofrojë formate fleksible të të mësuarit duke zgjeruar gradat dhe specializimet e nevojshme. Prandaj detyra jonë më e rëndësishme është përgatitja e studentëve për sfidat dhe mundësitë në të ardhmen.

Studenti i cili diplomohet në programin e studimit *Master i Shkencave* në *Financë-Kontabilitet*, mundet të vazhdojë studimet në një program të ciklit të tretë në *Financë*, *Kontabilitet* apo në një fushë të ngjashme. Bazuar në kriteret e vendosura nga Njësia bazë, sikurse edhe orientimi dhe preferenca e studentit, mbarimi i këtij cikli jep mundësinë për vazhdimin e studimeve në ciklin e tretë, në programet:

1. Doktoraturë në *Financë*
2. Doktoraturë në *Kontabilitet*

Vetëm pas mbarimit të këtij cikli studimi, studentëve do t’u hapen mundësitë për punësim më të sigurtë dhe për studime të mëtejshme, duke avancuar dijet e tyre në aspekte teorike dhe ato praktike.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Gjithnjë e më shumë tregu i punës po kërkon specialistë dhe ekspertë në fushat e *Financës* dhe *Kontabilitetit*, të kualifikuar me njohuri të tilla si menaxhimi i riskut, politikat fiskale e monetare, menaxhimi i buxheteve, auditimi i brendshëm dhe i jashtëm, analiza e strukturës së kostos së kapitalit etj. Për këtë arsye, synimi i programit të studimit *Master i Shkencave* në *Financë – Kontabilitet* është përgatitja e të diplomuarve të cilët do të plotësojnë kërkesën në rritje për këto pozicione që i kërkon tregu i punës.

Në këtë mënyrë, këta të diplomuar mund të punësohen në :

1. Institucione Financiare si: Banka të nivelit të dytë (Analist kredie, Shërbim me klientët, Specialist risku, Analist financiar, Specialist operacionesh, Menaxher filiali apo departamenti), Banka e Shqipërisë (Analist ekonomik, Inspektor financiar, Specialist në politikat monetare/fiskale).
2. Shoqëri Kontabiliteti dhe Auditimi si Auditues i brendshëm ose i jashtëm, Kontabilist i certifikuar (pas kualifikimeve të mëtejshme si CPA ose ACCA), Konsulent fiskal dhe financiar.
3. Administrata Publike dhe Institucione Shtetërore: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Institucione rregullatore (si AMF – Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare)

4. Bizneset private (të vogla, të mesme dhe korporata) si Financieri i ndërmarrjes, Drejtor financiar (CFO) Përgjegjës i kontabilitetit, Menaxher i riskut apo investimeve.
5. Firma Konsulence, si Konsulent financiar apo tatimor, Analist biznesi, Specialist i kontrollit të brendshëm.
6. Arsim dhe Kërkim, si Pedagog në universitete publike apo private (veçanërisht nëse ndjekin doktoraturë), të specializuar në mësimdhënie, gjithashtu edhe si kërkues shkencorë dhe Studiues në qendra kërkimore-shkencore si dhe në institute ekonomike e financiare.

Studentët që përfundojnë programin e studimit “Master i Shkencave” në Financë – Kontabilitet fitojnë njohuri të avancuara teorike dhe praktike në një sërë fushash të lidhura ngushtë me menaxhimin financiar dhe kontabilitetin modern. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e fushave kryesore të njohurive që ata përvetësojnë:

1. Kontabilitet i avancuar,
2. Financë e korporatave dhe menaxhim financiar
3. Analizë financiare dhe planifikim
4. Audit dhe kontroll i brendshëm
5. Tatime dhe legjislacion financiar
6. Menaxhim risku dhe tregje financiare
7. Kërkim shkencor dhe metodologji
8. Përdorimi i teknologjisë dhe software profesionale

Në përfundim të programit, studentët janë të përgatitur jo vetëm për punësim të menjëhershëm, por edhe për zhvillim të mëtejshëm profesional dhe studime doktorale, duke pasur një bazë të fortë dhe të specializuar në fushat e financës dhe kontabilitetit.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i parë				
1.	Tregjet dhe Institucionet Financiare	6	60	I
2.	E Drejtë Biznesi	6	60	I
3.	Standartet Ndërkombëtare dhe SKK të Kontabilitetit	6	60	I
4.	Metodat e Kërkimit Shkencor në Financë	6	60	I
5.	Analiza e Pasqyrave Financiare	6	60	II
6.	Sistemi Tatimor Tregëtar	6	60	II
7.	Menaxhim Projektesh	6	60	II
8.	Auditim	6	60	II
9.	Drejtimi Financiar i Avancuar	6	60	II
Gjithsej viti i parë		54 ECTS	540	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithsej	Semestri
Viti i dytë				
1.	Analizë kosto	6	60	I
2.	Analiza e Investimeve	6	60	I
3.	Kontabiliteti Financiar I Avancuar	6	60	I
Lëndë me zgjedhje				
7.	Shërbimet e Sigurisë dhe Konsulencës	6	60	I
	VlerësimPasurie			
8.	Organizimi I Sistemit të Kontrollit Kontabël	6	60	II
9.	Teoria Moderne e Investimeve	6	60	II
10.	Praktika	12	240	II
11.	Mikroteza	18	90	II
Gjithsej viti i dytë		66 ECTS	690	
Gjithsej viti i parë dhe viti i dytë (I+II)		120 ECTS	1230	